




Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë, 11/10/2012
Nr.0204 -1049

PËR: Isa Mustafa, Kryetar i Komunës Prishtinë
Engin Beyoglu, Zv.Kryesues i Kuvendit Komunës Prishtinë

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIEVE TË
KOMUNËS SË PRISHTINËS, NR. 01/020-35192, NR 01/031-35195.

Pranuar me datë, 03/10/ 2012

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores së Qeverisë 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimeve NR. 01/020-35192; 01/031-35195, të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, me datë 27.09.2012, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtyre akteve dhe vlerëson se të njëjtat janë në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Aktet juridike të listuara si vijon, të cilat kanë efekt të plotë juridik.

- Vendimi NR. 01/020-35192, për Emërimin e Anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" Sh.A.;
- Vendimi NR 01/031-35195, për Shpalljen e Ankandit Publik për Shitjen e Automjeteve që ju ka Kaluar Afati për Tërheqje nga Palët, sipas Urdhrit të Gjykatës,

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së
Drejtorëve të Departamenteve dhe Drejtorëve të Zyrave
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana, 11/10/2012
Br.0204 -1049

Za: Isa Mustafa, Gradonačelnik Opštine Priština
Sami Hamiti, Predsedavajući Skupštine Opštine Priština

PREDMET: POTVRDA ZAKONITOSTI ODLUKA OPŠTINE PRIŠTINA , BR. 01/020-35192, BR 01/031-35195.

Primljeno dana, 03/10/ 2012

Poštovani-e

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandator odredjenim po Zakonu za lokalnu samoupravu br. 03/L-040, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja Odluka BR. 01/020-35192; 01/031-35195, usvojenih od Skupštine Opštine Priština, dana 27.09.2012, **POTVRDJUJE** zakonitost ovih akata i procenjuje da su isti u skladu sa Zaknom za lokalnu samoupravu .

Navedena pravnaAkta koja sledeće, koja imaju puni pravni efekat.

- Odluka BR. 01/020-35192, o imenovanju planova opštinske komisije akcionara za lokalno javno preduzeće "Autobuska Stanica" A.D;
- Odluka BR 01/031-35195, o objavljivanju javnog nadmetanja za prodaju vozila kojima je istekao rok za uzimanje od stranaka,po nalogu Suda,

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik Premijera i Ministar MALS-a,

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Direktorima uprava i kancelarija
Arhivu MALS-a.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), nenit 5, paragrafi 5.1 të Ligjit nr. 03/L - 087, për ndërmarrjet publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 31/2008), nenit 3 të Ligjit nr. 2012/04 - L -111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L - 087, për ndërmarrjet publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 13/2012) dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 27.09.2012, merr këtë:

V E N D I M

PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE PËR NDËRMARRJEN PUBLIKE LOKALE "STACIONI I AUTOBUSËVE" SHA

I.

Miratohet Vendimi për emërimin e Komisionit komunal të aksionarëve për ndërmarrjen publike lokale "Stacioni i Autobusëve" SHA Prishtinë.

II.

Komisioni i aksionarëve, i cekur në pikën I të këtij vendimi, është në këtë përbërje:

1. Muhamet Nura;
2. Shefki Gashi.

III.


Komisioni ka të drejtë të veprojë në emër të Komunës, në përputhje me Ligjin për ndërmarrjet publike, Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrje publike dhe Ligjin për shoqëritë tregtare.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. nr. 020-35192, më 27.09.2012

Zv.kryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete
Engin Beyoglu





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), të nenit 101, paragrafi 101.1 të Ligjit nr. 02/L -70, për sigurinë në komunikacion rrugor, të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 27.09.2012, merr këtë

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E ANKANDIT PUBLIK PËR SHITJEN E AUTOMJETEVE QË IU KA KALUAR AFATI I TËRHEQJES NGA PALËT, SIPAS URDHËRESËS SË GJYQIT, P. NR. 2482/11, DT. 17.07.2012 PËR LIRIMIN E PRONËS SË PALAUJTSHME

I.

Miratohet Vendimi për shpalljen e ankandit publik për shitjen e automjeteve që iu ka kaluar afati i tërheqjes nga palët sipas urdhëresës së gjyqit, P. nr. 2482/11, dt. 17.07.2012, për lirim të pronës së palaujtshme.

II.

Shpallja e ankandit publik, të cekur në pikën I të këtij vendimi, bëhet për automjetet, të cilat pronarët nuk i kanë tërhequr brenda afatit prej 6 muajve nga dita e marrjes.

III.

Numri i automjeteve, lloji i automjeteve dhe targat e tyre për shitje në ankand publik, janë paraqitur në procesverbalin e dt. 27.8.2012, si pjesë përbërëse e këtij vendimi.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Departamenti i Prokurimit Publik.

V.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit të këtij vendimi.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. nr. 031-35195 dt 27.09.2012

Zv.kryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete
Engin Beyoglu

